

Kalket gjuhësore e zvetënojnë natyrën e gjuhës sonë

Mr. Agim Spahiu

16 prill 2002

Përmbledhje

Në këtë shkrim autori është marrë me një problematikë që i takon fushës së sociolinguistikës. Këtu ka marrë në shqyrtim një numër të konsiderueshëm ndërtimesh gjuhësore, të ashtuquajtura **kalke** të ardhura nga gjuhët sllave, sidomos nga serbishtja, të cilat edhe sot e kësaj dite po i ndeshim në ligjërimin bisedor e libror të një numër i konsiderueshëm i intelektualëve tanë, në Kosovë dhe në vise të tjera të banuar në shqiptarë. Prandaj, poenta e këtij shkrimi është që, sa më parë që të jetë e mundur, t'i flakim këto ndikime të huaja, sepse e bastadhojnë dhe e dëmtojnë shumë gjuhën tonë, ngase prekin thellë në strukturën sintaksore të saj. Kalket sintaksore janë shumë më të dëmshme sesa ato leksikor, sepse ato *ndërhyjnë në strukturën sintaksore* të një gjuhe, prandaj si rrjedhojë e kësaj janë shumë më të vështira për t'u shkoqur. Kjo gjë nuk është karakteristike vetëm për kalket që vijnë nga serbokroatishtja, por edhe nga gjuhët e tjera, siç është rasti me gjuhën angleze, e cila, në këto vitet e fundit, ka bërë një invazion të madh në të gjitha sferat e jetës të shqiptarët e Kosovës e gjetiu.

Në togfjalëshin **gabime gjuhësore** ne i përfshijmë jo vetëm gabimet drejtshkrimore e drejtshqiptimore, por edhe ato gramatikore, si p. sh. ndërtimet sintaksore të paformuara drejt e të zvetënuara nga gabimet e shumta, e sidomos të ndërtuarit e njërive sintaksore mbi bazën e gjuhëve të huaja, të ashtuquajturat **kalke gjuhësore**. Këto të fundit e rëndojnë për së tepërmi natyrën e cilësdo gjuhë, pra edhe atë të gjuhës sonë, ngase ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në strukturën sintaksore të tyre. Prandaj, si të këtilla, ato konsiderohen ndër më të rëndat.

Është një fakt gjuhësor që askush nuk mund ta mohojë: historikisht çdo gjuhë ka dhënë dhe ka marrë elemente nga gjuhët e tjera, e në mënyrë të veçantë nga ato fqinje. Edhe shqipja, natyrisht, ka dhënë dhe ka marrë, sidomos nga gjuhët sllave, por edhe nga gjuhët e tjera ballkanike e më gjerë. Elementet dhe ndikimet gjuhësore sllave janë shumë më të theksuara dhe më të hetueshme në shqipen e shqiptarëve të Kosovës, të Kosovës Lindore (Preshevë, Bujanoc, Medvegjë), të Maqedonisë e të Malit të Zi, nga vetë fakti se ne si komb i ndarë padrejtësisht me fajin e fuqive të mëdha, patëm mbetur për një kohë të gjatë të pushtuar e të administruar (madje këto pretendime janë evidente edhe sot) nga këta popuj sllavë të jugut (serbo - malazezët e maqedonasit). Në gjuhën tonë më

të theksuara janë, për fat të keq, elementet marrëse sesa dhënëse. Themi se kemi marrë më shumë elemente nga këto gjuhë sllave, ngase ato hetohen që nga fjalësi i një bujku a një punëtori të thjeshtë e deri te një intelektual me një përgatitje të mesme, por edhe të lartë shkollore. Pra, edhe sot kur Kosovën dhe disa vise të tjera po i konsiderojmë të çliruara kushtimisht nga këta pushtues të egër shekullorë, shumë intelektualë nuk po mund të çlirohen njëherë e përgjithmonë nga këto *shprehi gjuhësore* të krijuara me vite e dekada të tëra. Kjo, mendojmë, është më brengosëse për kategorinë e intelektualëve të cilët flasin shqip, por gjithnjë duke u shprehur me formulat stereotipe sllave.

Përdorimi i fjalëve të huaja nga ana e folësve të një gjuhe tjetër, në instancë të fundit, nuk duhet të konsiderohet si një çështje shumë problemore dhe e patejkalueshme, (si fjala vjen, përdorimi e vazhdueshëm i fjalëve të gjuhës serbokroate, si: *struja, porezi, drzhava, perzorja, zavodi, knjizica* e shumë e shumë të tjera të këtilla nga ana e shqipfolësve), sepse me kalimin e kohës dhe me heqjen qafe të këtyre pushtuesve nga trevat tona, ato gradualisht do të zëvendësohen me fjalët shqipe (sepse logjikisht, duke i dëgjuar dhe duke i përdorur rregullisht fjalët shqipe në vend të atyre serbokroate, të parat do të nguliten në ndjenjën gjuhësore të shqipfolësve, kurse të dytat do të kalojnë në shtresën pasive dhe një ditë ato do t'i harrojnë krejtësisht). Por çështja më problemore dhe më brengosëse mbetet fakti i përdorimit të kalkeve të ardhura nga kjo gjuhë të cilat kanë zënë rrënjë në fjalësin e shumë njerëzve, kryesisht intelektualë të cilët e kanë folur, e kanë shkruar, por edhe kanë studiuar me literaturën e kësaj gjuhe. Pastaj ky grup (që nuk është edhe i vogël ndër shqipfolës) ka një ndikim të dukshëm edhe te pjesa tjetër që nuk është aq njohëse e mirë e kësaj gjuhe të huaj dhe që nuk e ka atë nivel arsimor, por që shumë herë ndoshta në mënyrë të pavetëdijshme i përdor ato ndërtime gjuhësore, (meqë kontakti është i drejtpërdrejtë me këta njerëz dhe me literaturën e tyre, e në veçanti me shtypin tonë të përditshëm). Këta njerëz, në njëfarë mënyre, janë mishëruar me strukturën e kësaj gjuhe, prandaj edhe kur komunikojnë me të tjerët, përdorin fjalë e shprehje shqipe sipas gjedheve të gatshme të kësaj gjuhe. Prandaj, këtu qëndron edhe vështirësia e mënjanimimit dhe e luftimit të tyre te këta individë.

Shumë gjuhëtarë shqiptarë me kohë e kanë parë rrezikun e bastardhimit të gjuhës sonë nga ndikimet që vijnë nga kjo gjuhë, por edhe nga gjuhët e tjera. Prandaj, përmes shkrimeve të tyre, gjithnjë kanë porositur intelektualët shqiptarë, dhe sidomos publicistët që të mos i përdorin ndërtimet sintaksore që vijnë nga kjo gjuhë ose nga gjuhët e tjera sllave dhe mundësisht t'i shmangin e t'i zëvendësojnë ato me fjalë e shprehje më të natyrshme të gjuhës sonë, sepse vetëm kështu mund të ruhet origjinaliteti i gjuhës sonë. Por një gjë e tillë te një pjesë e madhe e këtyre njerëzve ka hasur në veshë të shurdhët, në këto vitet e fundit. Këtë mesazh e përmban edhe ky shkrim dhe i porositi edhe njëherë të apostrofuarit se ndërtimet sintaksore të llojit si p. sh.:

1. **Thirrem në këtë ose atë;**
2. **Erdhi deri te prishja;**
3. **Nuk vjen në shprehje;**
4. **X/Ky/Kjo numëron kaq e kaq;**

5. U përgjigj në pyetjen;
6. Nuk është në pyetje;
7. Prapa dyerve të mbyllur;
8. Kjo nuk guxon të ndodhë;
9. Duke iu falënderuar dikujt;
10. E ndaj mendimin me dikë;
11. Është më tepër se e vërtetë etj. etj.

Si në shembujt e mëposhtëm:

Thirrem në parimet kushtetuese. Këtë duhet ta realizojnë edhe ndërkombëtarët, të cilët gjenden në Kosovë, e të cilët aq shumë *thirren në respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut*. Në Kosovën e okupuar ndodhi një proces i kundërt dhe regresiv, ashtu që *erdhi deri te rietatizmi i pronës* mbi mjetet e prodhimit; Një zyrtar tjetër i administratës tha se megjithatë përdorimi i trupave ushtarake amerikane ndaj rebeleve *nuk vjen në shprehje*; Spanja *numëron ... banorë*. ; ... siç *u përgjigj në një pyetje të gazetarit tonë*; Kur *është në pyetje Korea e Veriut* politika jonë ngelet politikë e shpresës; Mbledhja u mbajt *prapa dyerve të mbyllura*; Dëgjuesi dhe shikuesi i frekuencave të radios dhe kanalit të **Televizionit 21**, *nuk guxon të lëndohet*, përkundrazi ai do të gjejë shijen e vlerës dhe do të mbetet në valët tona për një kohë të gjatë; ... *dhe duke iu falënderuar donatorëve të jashtëm* si dhe menaxhimit të suksesshëm të përgjegjësve vendës, është arritur që në këtë fazë të shënohen rezultate të dukshme; ..., ndërsa që të katër partitë, nënshkruese të Marrëveshjes kornizë, *ndajnë mendimin* se patjetër, në këtë përbërje parlamentare, të sillen ligjet e parapara me këtë marrëveshje; ..., por përmasat e përjetimit *janë më tepër se fantastike*; Të krijosh në rrethana totalitare *është më tepër se fatkeqësi* etj.

Të gjitha këto ndërtime dhe të ngjashme si këto nuk është mirë që të mos përdoren as në gjuhën e folur e as në të shkruarën, sepse janë të gatuar nga një brumë i gjuhës serbe, ose kjo e fundit i ka përvetësuar nga gjuhët e tjera dhe pastaj në mënyrë të tërthortë janë reflektuar në gjuhën tonë.

Shembujt e lartshënuar do të duhej ta kishin mbështetjen përafërsisht në këtë këtë gjuhë sllave që tingëllojnë përafërsisht kështu: *Pozivati na... ; Doslo je do kvara; Ne dolazi u obzir; Broji toloko i toliko... ; Odgovoriti na pitanju; (ni) je u pitanju; Iza zatvorenih vrata; Ne sme to da se dogodi; zahvaljajuci na... ; deliti misljenje... ; je vise nego istinito.*

Këto e të ngjashme e dëmtojnë shumë identitetin dhe origjinalitetin e gjuhës sonë. Prandaj, në vend që të themi: *thirren në respektimin e të drejtave dhe të lirive të njeriut*, ne mendojmë se më mirë është të thuhet: **Mbështetem në respektimin e të drejtave dhe të lirive të njeriut, i respektoj ligjësisht të drejtat dhe liritë e njeriut, mbështetem / bazohemi në parimet kushtetuese...ose i përfill / përlligj parimet kushtetuese** etj. ; në vend të: *erdhi deri te rietatizmi i pronës*, më mirë është të thuhet: **u bë rietatizmi i pronës/ u krijua rietatizmi i pronës, u**

rietatizua prona mbi mjetet e prodhimit etj; në vend të: *nuk vjen në shprehje*, më mirë është të thuhet shqip: **(nuk) manifestohet, (nuk) shfaqet, nuk merret parasysh, është e pamundur; nuk mund të ndodhë, gjë që s' bëhet** etj. (varësisht nga konteksti); pastaj; në vend të: *Spanja numëron kaq milionë banorë*, më mirë: **Spanja ka kaq milionë banorë**; në vend të: *u përgjigj në pyetjen*, më mirë është të thuhet: **iu përgjigj pyetjes**; në vend të: kur (nuk) *është në pyetje...*, është më mirë të themi shqip: kur **është fjala (çështja) për...**; në vend të: *prapa dyerve të mbyllura*, më mirë është të thuhet: **me dyer të mbyllura /mbledhja u mbajt me dyer të mbyllura/**; në vend të: *nuk guxon të lëndohet*, më mirë është të thuhet: **nuk bën të lëndohet** dëgjuesi ose s' **është mirë të lëndohet ose injorohet ose fyhet** dëgjuesi etj. ; në vend të: *duke iu falënderuar atij a asaj, ...* është më mirë e më drejt po të thuhet: **në saje të atij a asaj ose falë atij a asaj** ; në vend që të thuhet: *ndaj mendimin me dikë*, shqip është më mirë të thuhet: **jam i mendimit, mendoj, edhe unë e kam (e mbaj) të njëjtin mendim etj.** , por jo *të ndaj mendimin* me dikë; sepse mendimi s' mund të ndahet; në vend të: *më shumë se e vërtetë, më shumë se fantastike, /fatkeqësi* etj., shqip mund të thuhet: **është shumë e vërtetë, më se e vërtetë, (është tepër fantastike), është një fatkeqësi e madhe, një fatkeqësi e jashtëzakonshme** etj;

Kësaj liste mund t' i shtohen edhe disa dhjetëra shembuj të këtyllë të ngjashëm që po përdoren në mediat tona, të shkruara dhe elektronike. Por ne nuk do të zgjatemi më shumë për këtë problematikë në këtë shkrim.